

**URDHËR**  
**Nr.30, datë 5.7.2006**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR.10, DATË 10.3.2005 TË MINISTRIT TË FINANCIVE**  
**“PËR SEKUESTRIMIN E PASURIVE TË FONDACIONIT “AL HARAMANIA”(AL**  
**HARAMAIN), I CILI REZULTON I SHPALLUR NË LISTËN E FINANCUESVE TË**  
**TERRORIZMIT”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr.9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, ligjit nr.9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.718, datë 29.10.2004 “Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit”, i ndryshuar,

**URDHËROJ:**

Në urdhrin nr.10, datë 10.3.2005 bëhet ndryshimi si më poshtë vijon:

1. Mbas pikës 4, shtohet pika 4.1 me këtë përmbajtje:

“Të sekuestrohet:

Pasuria “Vilë 2-katëshe” e fondacionit “Al Haramania”, me sipërfaqe trualli 432 m<sup>2</sup> dhe me sipërfaqe ndërtimi 157 m<sup>2</sup> në zonën kadastrale nr.8260, numër pasurie 6/229, volumi 15, faqe 141, me adresë: rruga:”Irfan Tomini”, nr.58 Tiranë.

2. Ngarkohen me zbatimin e këtij urdhri, institucionet e përcaktuara në ligjin nr.9258, datë 15.7.2004, subjektet dhe autoritetet raportuese të përcaktuara në ligjin nr.8610, datë 17.5.2000 “Për parandalimin e pastrimit të parave”, i ndryshuar, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara pranë Ministrisë së Financave.

3. Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I FINANCIVE**  
**Ridvan Bode**